



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002675/2

Tiranë __16__/_7__/_2020

Lënda: Rekomandim për përmirësimin e instrumentave ligjorë për zbatimin në praktikë të së drejtës së fëmijës për t'u argëtuar

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRISË SË DREJTËSISË

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

**AGJENSISË SHTETËERORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE
TË FËMIJËS**

TIRANË

Të nderuar,

Më lejoni, që nëpërmjet këtij komunikimi, të ndaj me Ju shqetësimin, për ngjarjet tragjike të humbjes së jetës së dy fëmijëve, përkatësisht në qytetet e Beratit dhe Korçës.

Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, Avokati i Popullit, me nismën e vet, filloi procedurën e shqyrtimit të rasteve në fjalë.

Më konkretisht, në rastin e parë, bëhet fjalë për ngjarjen e rëndë të ndodhur në qytetin e Beratit. Fëmija 4-vjeçar me iniciale E.B., ndërsa ka qenë duke luajtur, ka humbur jetën, për shkak se ka rënë në kontakt me energjinë elektrike. Shkak, mendohet të jenë bërë punimet e lëna përgjysmë për ndriçuesit, që bashkia e këtij qyteti ka vënë për dekorimin e tij në raste festash. Ngjarja bëhet më e dhimbshme, pasi ajo ka ndodhur në një park publik, ku vazhdimisht janë të pranishëm fëmijë të të gjitha moshave.

Po kështu, një tjetër humbje e jetës në mënyrë tragjike, e fëmijës me inicialet S.Ç., 8 vjeç, për shkak të mungesës së sinjalistikës në basenin me ujë (shatërvan) të parkut në Bashkinë Korçë. Ky lajm është publikuar në programin investigativ “Fiks fare” në televizionin kombëtar Top Channel, në 21 maj 2020.

Në përmbushje të funksionit kushtetues, Avokati i Popullit, në funksion të monitorimit të zberthimit, që institucionet shtetërore përgjegjëse, i bëjnë në praktikë, parimit të interesit më të lartë të fëmijës, konkretisht katalogut të të drejtave të fëmijës, në këtë rast, garantimit të të drejtës për t’u argëtuar¹, realizoi një analizë sistematike të përputhshmërisë së legjislacionit të brendshëm, zbatimit të tij në praktikë, me standardet e vendosura në Konventë.

Në vlerësim të informacionit të gjeneruar nga mediat e shkruara dhe vizive, institucioni i Avokatit të Popullit, për garantimin e të drejtës së fëmijës për pushim dhe argëtime kulturore e sportive², në analizimin e rrethanave dhe ngjarjeve të ndodhura, monitoroi *online* punën e këtyre institucioneve shtetërore përgjegjëse, në drejtim të krijimit të hapësirave të nevojshme, brenda mundësive, për lojërat e fëmijës dhe, masat që ato duhet të ndërmarrin për zbatimin e instrumenteve ligjorë detyrues, si vijon:

- miratimin e kuadrit rregullues urbanistik, si dhe të akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore për të garantuar hapësira urbane të përshtatshme dhe aksesin e sigurt në mjedise sportive, kënde lojërash ose mjedise të tjera çlodhëse për të gjithë fëmijët, pavarësisht moshës, gjinisë, racës, etnisë, aftësisë ose kushteve sociale ekonomike;

¹Neni 31, i Konventës për të Drejtat e Fëmijës - E drejta e fëmijës për t’u argëtuar dhe për të marrë pjesë lirish në jetën kulturore dhe artistike, transpozuar drejtëpërdrejt edhe në nenin 19, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

² Shih nenin 19, të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ku në mënyrë eksplicite parashikohet, se : **“...autoritetet publike qendrore e vendore, brenda kompetencave të tyre, marrin masa konkrete për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe mundësive të barabarta për ushtrimin e aktiviteteve kulturore, artistike e çlodhëse për të gjithë fëmijët...”**.

- vendosjen e standardeve të sigurisë dhe aksesimit për të gjitha mjediset çlodhëse e këndet e lojërave, me qëllim mbrojtjen e fëmijës nga dëmtimet e mundshme të shëndetit;
- krijimin e hapësirave të përshtatshme për të mundësuar ushtrimin e sigurt dhe gjithëpërfshirës të veprimtarive sportive, kulturore e dëfryese në mjediset shkollore dhe komunitare;
- hartimin e kurrikulave shkollore, të cilat krijojnë mundësi që fëmijët të kenë kohë të mjaftueshme për lojëra, çlodhje dhe veprimtari sportive.

Duke marrë në konsideratë dhe vlerësuar, instrumentet detyruese të legjislacionit të brendshëm, që i njohin fëmijës të drejtën për të pushuar, argëtuar, praktikimin e lojrave dhe veprimtarive çlodhëse në përshtatje me moshën, më poshtë paraqesim në mënyrë të përmbledhur këtë legjislacion:

- ligjin nr.9062 datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, të ndryshuar;
- ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar” të ndryshuar;
- ligjin nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- ligjin nr.75/2019 “Për rininë”;
- ligjin nr.79/2017 “Për sportin”;
- ligjin nr.10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar;
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat Fëmijëve 2017-2020³
- vendimin nr.383, datë 6.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020”;
- Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2019-2025.

Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor

Kodi i Familjes⁴ nuk parashikon në mënyrë eksplicite të drejtën e fëmijës për të luajtur, argëtuar dhe pushuar. Pavarësisht, se kjo e drejtë mund të burojë nga interpretimi i Parimeve të Përgjithshme⁵ dhe përkufizimit të përgjegjësisë prindërore⁶, një detajim më konkret në pjesën e përgjegjësisë prindërore të së drejtës së fëmijës për të luajtur, argëtuar e pushuar do të ishte

³Miratuar me vendimin nr.372, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020”

⁴Ligji nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”

⁵Në nenin 5 të KF, përcaktohet se: “...fëmijët kanë të drejtë për një “zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit të tyre” dhe “rritje në një atmosferë gëzimi dhe mirëkuptimi”...”.

⁶Në nenin 215, të KF jepet kuptimi i përgjegjësisë prindërore, ku parashikohet se: “... prindërit kanë të drejtën dhe detyrimin t’u sigurojnë fëmijëve të tyre mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale, duke u kujdesur për ta, duke mbajtur raporte vetjake, duke u siguruar atyre mirërritjen, edukimin, arsimimin. Termat mirëqenie emocionale, sociale dhe sigurimi i mirërritjes përmbajnë, në një interpretim të tyre, edhe elementet e garantimit të së drejtës për të luajtur, argëtuar e pushuar si të domosdoshëm për mirërritjen dhe mirëqenien emocionale...”.

e nevojshme. Legjislacioni në mënyrë deklarative, përcakton si një nga qëllimet e arsimit, emancipimin shpirtëror të individit⁷, duke e lidhur në këtë mënyrë të drejtën për edukim, me të drejtat e tjera të rëndësishme për fëmijën, si ajo për pushim, argëtim, pjesëmarrje në aktivitete kulturore dhe artistike, etj., të cilat ndikojnë në zhvillimin tërësor të fëmijës. Megjithatë, ky është një parashikim me karakter deklarativ dhe, zbatimi në praktikë i këtij parimi kërkon detajime konkrete.

Gjithashtu, **Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar** përcaktojnë synimet e shkollës⁸ për emancipimin shpirtëror të nxënësve dhe përmbajnë një kre të veçantë⁹, i cili i dedikohet vetëm veprimtarive jashtëshkollore, ku ngarkohet shkolla, që në përputhje me kushtet, mundësitë dhe objektivat e saj, të zhvillojë veprimtari jashtëshkollore me nxënësit, të cilat duhet të jenë të larmishme, ku renditen veprimtaritë kulturore-artistike, sportive letrare, higjieno-shëndetësore, eskursione, vizita turistike e piknikë¹⁰. Në këtë kuadër, drejtorja e shkollës harton planin vjetor të veprimtarive jashtëshkollore, duke evidentuar edhe veprimtaritë jashtëshkollore, pa mbingarkuar nxënësit, duke afirmuar në këtë mënyrë balancimin e aktiviteteve, në të cilat përfshihen fëmijët me të drejtën për pushim¹¹.

Reformimi i kuadrit ligjor¹² për pushtetin vendor, përcakton në mënyrë të përgjithshme funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese¹³ për zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e bibliotekave e të ambienteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve, si dhe organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve, që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

⁷ Nenet 3, 21 dhe 22, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të parashikojnë se: “... *arsimi parashkollor dhe ai bazë synojnë zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor, zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës...*”

⁸Urdhri nr.31, datë 21.1.2020, i ministrit të Arsimit, sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH”

⁹ Neni 26, i urdhrin nr.31, datë 21.1.2020, i ministrit të Arsimit, sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH”

¹⁰ Neni 26 dhe 27, të urdhrin nr.31, datë 21.1.2020, të ministrit të Arsimit, sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH”

¹¹ Pika 2, e nenit 27, e urdhrin nr.31, datë 21.1.2020, të ministrit të Arsimit, sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH”, ku parashikohet detyrimi i institucioneve arsimore, për hartimin e planeve vjetore të eskursioneve, që në fillim të vitit mësimor.

¹² Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

¹³ Neni 25, i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Për herë të parë, përmirësimi i kuadrit të ri ligjor¹⁴ për sportet, mundësoi përfshirjen të edukimit fizik dhe sportit shkollor në një kapitulli të veçantë, si dhe përcaktimin e kufirit minimal të ngarkesës mësimore të lëndës së edukimit fizik në kurrikulën bërthamë, organizimin e federatave të sportit shkollor dhe universitar, në funksion të institucionalizimit dhe organizimit të veprimtarisë sportive në institucionet arsimore.

Në këtë kontekst, në sistemin arsimor parauniversitar, lëndës “Edukim fizik, sporte dhe shëndet”, i jepet një përkufizim më i gjerë, duke parashikuar ngarkesën mësimore të saj, numrin e orëve për klasat e para deri në klasat e dymbëdhjeta. Në vitin shkollor 2014-2015, në të gjitha nivelet e klasave të para deri të dymbëdhjetë, lënda e edukimit fizik është rritur me tre orë në javë, si rezultat i ndryshimit në kurrikulën bazë të realizuar në kuadër të reformës arsimore në vend. Në lëndën e edukimit fizik janë përfshirë njohuri mbi çështjet e shëndetit, për t’u ofruar studentëve informacion të vlefshëm në ndërtimin e një mënyre jetese të shëndetshme.

Në lëndën e edukimit fizik, klasat 1-5 operojnë me 350/45 min orë mësimi (total në 5 vjet) dhe në klasat 6-9, operojnë me 280/45 min orë mësimi (total për 4 vjet). Në arsimin e lartë të mesëm operohet me 252/45 min orë mësimi (totali në 3 vjet)¹⁵.

Gjithashtu, përveç disiplinës mësimore të përfshirë si pjesë e kurrikulës, aktivitetet sportive në institucionet arsimore parauniversitare dhe universitare jashtë procesit mësimor, organizohen edhe nga shoqatat sportive shkollore dhe shoqatat sportive universitare, të cilat mund të jenë të një sporti ose të shumë sporteve, veprimtaria e të cilave koordinohet sipas përkatësisë nga Federata e Sportit Shkollor dhe Federata e Sportit Universitar.

Federata Shqiptare e Sportit Shkollor dhe Federata Shqiptare e Sportit Universitar janë persona juridikë, që organizohen dhe funksionojnë në zbatim të kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse. Ministria përgjegjëse për sportin njih vetëm një federatë të sportit shkollor dhe një federatë të sportit universitar dhe, asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e këtyre federatave.

Konkretisht, Federata Shqiptare e Sportit Shkollor dhe Federata Shqiptare e Sportit Universitar, krahas detyrave statutore, kanë edhe këto detyra:

¹⁴ Ligji nr.79/2017 “Për sportin”

¹⁵ Neni 6, i ligjit nr.79/2017 “Për sportin”

- të organizojnë, drejtojnë, kontrollojnë dhe të vëzhgojnë veprimtaritë sportive me nxënësit e të gjitha grup-moshave të arsimit parauniversitar në nivel rajonal dhe kombëtar, në të gjitha disiplinat sportive;
- të organizojnë kampionatin e shkollave në të gjitha disiplinat sportive dhe të shpallin kampionin kombëtar të shkollave;
- të organizojnë ekipet përfaqësuese në veprimtaritë ndërkombëtare të sportit shkollor.

Kuadri i ri ligjor solli edhe zbatimin në praktikë të projekteve të reja, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe federatave të sporteve përkatëse, konkretisht, si vijon:

- në qershor të vitit 2015, u firmos marrëveshja e parë e bashkëpunimit¹⁶ ndërmjet Federatës Botërore të Shahut, Federatës Shqiptare të Shahut dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, objekt i së cilës është zbatimi i projektit “Mësime të shahut në shkolla”;
- në nëntor të vitit 2015, u firmos marrëveshja e bashkëpunimit, midis Federatës Shqiptare të Xhudos dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë¹⁷, për zbatimin e projektit “Mësime të xhudos në shkolla”;

¹⁶ Marrëveshja e bashkëpunimit nr.4661/1, datë 18.6.2015, e cila konsiston në mundësimin e marrjes së leksioneve dhe njohurive mësimore falas mbi lojën e shahut nga nxënësit e shkollave, nëpërmjet aktiviteteve ekstrakurrikulare në laboratorët e teknologjisë së informacionit të shkollave. Gjithashtu, pjesë e marrëveshjes është dhe regjistrimi dhe anëtarësimi me dëshirë të nxënësve online në Federatën Botërore të Shahut, Federatën Shqiptare të Shahut, nëpërmjet linkut përkatës, zhvillimi i orëve mësimore ekstrakurrikulare në formën e praktikave zbavitëse, si dhe garave sportive të organizuara, si dhe zhvillimi i lojërave *online*, të aksesuara për nxënësit e anëtarësuar. Pjesë e këtij projekti është dhe trajnimi i 40 mësuesve nga 16 shkolla 9-vjeçare të qytetit Tiranës dhe pajisja e tyre me licencë ndërkombëtare FIDE (instruktor shkollash). Po kështu, organizimi në Shqipëri, për herë të parë i Kampionatit Botëror të Shahut për shkollat, 2018, në Durrës, si dhe projekti “Shahu për Zhvillimin e Komunitetit” (prill 2019). *Shpenzimet financiare për zhvillimin e projektit mbulohen tërësisht nga Federata Shqiptare e Shahut, mbështetur nga Federata Evropiane dhe ajo Botërore e Shahut (parashikuar në marrëveshje).*

¹⁷ Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 9322, datë 12.11. 2015, objekt i së cilës është mësimi i sportit të xhudos në shkolla. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje erdhi si rezultat i kërkesës së Unionit Evropian të Xhudos (EJU), nëpërmjet Federatës Kombëtare të Xhudos, për implementimin e projektit “*Mësime të Xhudos në Shkollë*” (Judo@School®), në institucionet arsimore parauniversitare të vendit tonë, për të mundësuar evidentimin, trajnimin e talenteve dhe njëkohësisht, mundësimin e ushtrimit të sportit të xhudos nga fëmijët e të rinjtë në shkolla. Ky projekt prej disa vitesh po zhvillohet në shkolla të disa vendeve të Evropës, ku dhe ka rezultuar i suksesshëm e me vlera, si në fushën e evidentimit dhe trajnimit të talenteve, po ashtu edhe si kontribues në edukimin psiko-fizik të fëmijëve e të rinjve. Projekti i xhudos konsiston në zbatimin e një programi, që përmban leksione dhe orë mësimore për t’u njohur me sportin e xhudos dhe fillimin e tij si një praktikë zbavitëse dhe jetësore, në përputhje të plotë me zhvillimin fizik e mendor të moshave përkatëse. Zbatimi i këtij projekti është falas për komunitetin, që do të thotë se trajnerët dhe instruktorët e Federatës, që janë të angazhuar në projektin “Judo për fëmijë”, japin leksione falas për komunitetin në shkollat – qendra komunitare. Gjithashtu, edhe baza materiale (tatami, dyshekë speciale etj.), e ofruar nga Federata, i mbetet shkollës së përfshirë në projekt (kusht i marrëveshjes). Pjesë e këtij projekti është trajnimi i 20 mësuesve të edukimit fizik nga 20 shkolla të arsimit parauniversitar në rang vendi, për realizimin e kampionateve të shkollave në disiplinën e xhudos. *Shpenzimet financiare për zhvillimin e projektit mbulohen tërësisht nga Federata Shqiptare e Xhudos, mbështetur nga Federata Evropiane e Xhudos (parashikuar në marrëveshje).*

- në prill të vitit 2016, u firmos marrëveshja e bashkëpunimit, ndërmjet Federatës Shqiptare të Hendbollit dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë¹⁸, objekt i së cilës është zbatimi i projektit “Mësime të hendbollit në shkolla”;
- në dhjetor të vitit 2017, u firmos marrëveshja e bashkëpunimit, midis Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë¹⁹, për zbatimin e projektit “Mësime të futbollit në shkolla – “Grow 2020”;
- në shkurt të vitit 2018, u firmos marrëveshja e bashkëpunimit, ndërmjet Federatës Shqiptare të Basketbollit dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë²⁰, për zbatimin e projektit “Mësime të basketbollit në shkolla”.

¹⁸ Kjo marrëveshje bashkëpunimi nr.4073, datë 18.4.2016, erdhi si rezultat i aplikimit të Federatës Shqiptare të Hendbollit pranë Federatës Evropiane të Hendbollit, për mbështetjen e një projekti 3-vjeçar, të titulluar “Priority”, për zhvillimin e sportit të hendbollit edhe në Shqipëri, pjesë e të cilit është dhe projekti “Mësimi i lojës së hendbollit” (objekt i marrëveshjes). Ky projekt konsiston në ofrimin e mësimeve dhe trajnimit të nxënësve të shkollave 9-vjeçare në të gjithë vendin, në formën e veprimtarive zbatimëse dhe garuese ekstrakurrikulare. Zbatimi i tij është falas për komunitetin, që do të thotë se trajnerët dhe instruktorët e Federatës, që janë të angazhuar në projekt, japin leksione falas për komunitetin në shkollat – qendra komunitare. Gjithashtu, edhe baza materiale (porta, topa, uniforma etj.), e ofruar nga Federata, i mbetet shkollës së përfshirë në projekt (kusht i marrëveshjes). Pjesë e këtij projekti është trajnimi 140 mësuesve në qytete Shkodër, Vlorë, Tiranë dhe Elbasan dhe pajisja e tyre me licencë ndërkombëtare të tipit “D”, dhënë nga Federata Botërore e Hendbollit (IHF). *Shpenzimet financiare për zhvillimin e projektit mbulohen tërësisht nga Federata Shqiptare e Hendbollit, mbështetur nga Federatat Evropiane dhe Botërore e Hendbollit (parashikuar në marrëveshje).*

¹⁹ Marrëveshja e bashkëpunimit nr.1660, datë 12.12.2017, u realizua si nevojë për zbatimin e projektit “Grow 2020”, të lancuar dhe drejtuar nga UEFA, nëpërmjet Fondacionit “Për fëmijët”. Në këtë kuadër, edhe Shqipëria si shumë vende të tjera, është përfshirë në zbatimin e një prej projekteve më të suksesshme të UEFA-s, “Grow 2020”, i cili konsiston në ofrimin e mësimeve falas të futbollit në shkolla, duke startuar me klasat e para, të dyta dhe të treta (grup-mosha 7-9 vjeç). Nëpërmjet këtij projekti, synohet të realizohet, jo vetëm masivizimi i sportit të futbollit nëpërmjet përfshirjes së nxënësve të shkollave, por edhe gjithë përfshirja, barazia gjinore dhe rritja e cilësisë së mësimdhënies (referuar orëve mësimore dedikuar disiplinës së futbollit). Nga ky projekt, nëpërmjet promovimit të sportit të futbollit, përfitohet rritja e nivelit të veprimtarisë fizike për një jetë më të shëndetshme tek fëmijët, argëtimi i fëmijëve, duke u bërë pjesë e lojës, përkrahet dhe promovohet barazia gjinore, forcohet bashkëveprimi social, rritet vetëbesimi tek fëmijët, krijohet mundësia, që një sport kaq i dashur të kthehet në një profesion të vlefshëm në të ardhmen. Projekti është parashikuar të zgjasë 3 vite dhe të aplikohet në 6 qytete: Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Korçë dhe Shkodër. Pjesë e këtij projekti është trajnimi i 200 mësuesve në qytetet Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Shkodër dhe pajisja e tyre me licencë ndërkombëtare të tipit “D”, dhënë nga Federata Evropiane e Futbollit (UEFA). *Shpenzimet financiare për zhvillimin e projektit mbulohen tërësisht nga Federata Shqiptare e Futbollit, mbështetur nga UEFA (parashikuar në marrëveshje).*

²⁰ Marrëveshja e bashkëpunimit nr.2028/1, datë 23.2.2018, e cila konsiston në ofrimin e mësimeve falas të basketbollit për nxënësit e shkollave 9-vjeçare në disa qytete të vendit, si veprimtari ekstrakurrikulare, duke startuar me klasat e para, të dyta dhe të treta (grup-mosha 7-9 vjeç) dhe deri me nxënësit e klasave më të larta (grup-mosha 14-15 vjeç). Aktualisht, ky projekt është shtrirë vetëm në qytetin e Tiranës, me pritshmëri për të vazhduar me shtrirjen e tij edhe në qytetet e tjera të vendit. Objektivat kryesorë, që synohen të realizohen nëpërmjet këtij projekti, janë jo vetëm në kuadër të masivizimit të sportit të basketbollit nëpërmjet përfshirjes së nxënësve të shkollave, por edhe të rritjes profesionale të mësuesve të edukimit fizik (referuar perfeksionimit të mësimdhënies së orëve mësimore dedikuar disiplinës së basketbollit). Zbatimi i projektit “Mësime të basketbollit në shkollë” konsiston në organizimin dhe përfshirjen e nxënësve në veprimtari promovionale dhe në bashkëpunim me Federatën e Sportit Shkollor edhe të veprimtarive konkurruese (kampionate rajonale e kombëtare), si dhe ofrimin e bazës së nevojshme materiale për shkollat e përfshira në projekt, të gjitha këto të financuara nga Federata e Basketbollit.

Ndërkohë, në vitin shkollor 2018-2019, nisi të formësohet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nisma “Për klasat e profilizuara në sport–klasat sportive”, pas një studimi të realizuar për këtë qëllim nga Sektori i Programeve të Zhvillimit të Sportit në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Identifikimi dhe vlerësimi i shkollave të arsimit bazë të sistemit parauniversitar, të cilat kanë hapur klasa të profilizuara në sport, u realizua në mbështetje të ligjit nr.69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.79/2017 “Për sportin” dhe urdhrin nr.440, datë 2.5.2018 “Për hapjen e klasave të profilizuara në sport në shkollat e arsimit bazë të sistemit parauniversitar”. Në zbatim të kërkesave të parashikuara nga urdhri i mësipërm, për vitin mësimor 2018-2019, nga njësitë arsimore vendore u identifikuan shkollat me potencial infrastrukturor, njerëzor dhe material-didaktik, për hapjen e klasave të profilizuara në sport, sipas parashikimit, që ato të hapeshin në profilet sportive futboll, basketboll dhe volejboll²¹.

Në këtë kontekst, në rang vendi janë krijuar 223 klasa sportive, në 121 shkolla të arsimit bazë (AMU 6-9 dhe cikli 1-9), me shtrirje gjeografike thuajse në të gjithë territorin e vendit.

	Gjithsej
	Numër
Shkolla me klasa sportive (gjithsej)	121
Klasa gjithsej në shkollat me klasa sportive	3,403
Nxënës gjithsej në shkollat me klasa sportive	66,932
Klasa sportive (gjithsej)	223
Nxënës në klasa sportive (gjithsej)	5,616

Shpenzimet financiare për zhvillimin e projektit mbulohen tërësisht nga Federata Shqiptare e Basketbollit (parashikuar në marrëveshje).

²¹ Procedurat dhe kriteret për hapjen, organizimin dhe funksionimin e klasave të profilizuara në sport (2019-2020), parashikohen në udhëzimin e përbashkët nr.18, datë 20.8.2019, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe “Për vitin shkollor 2019–2020 në sistemin arsimor parauniversitar”, si dhe në urdhrin nr.31, datë 28.1.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020²² parashikon një sërë masash, për përfshirjen dhe krijimin e mundësive për veprimtari rekreative për të rinjtë. Ky dokument bazë bashkërendon punën për zbatimin e politikave ndërsektoriale rinore²³, si punësimin e të rinjve, arsimin profesional, praktikën mësimore, ngritjen e qendrave rinore, mbrojtjen e shëndetit të të rinjve, rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete social-kulturore dhe proceset vendimarrëse.

Një nga objektivat specifike, në zbatim të Planit të Rinisë ka qenë ngritja e Shërbimit Kombëtar të Rinisë (SHKR), si institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave dhe programeve rinore. Gjatë vitit 2017, ish-Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka ngritur tre qendrat rajonale Rinore në Tiranë, Korçë dhe Vlorë, si njësi të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve për të rinjtë, për të zhvilluar veprimtari kulturore, sociale dhe sportive, në përputhje me politikën dhe programet e miratuara nga kjo ministri. Gjithashtu, ato janë dhe qendra informative, të cilat do të mbështesin të rinjtë në krijimin dhe realizimin e aktiviteteve dhe organizatave të shoqërisë civile për rininë. Por, gjatë periudhës kohore 2017-2020, shohim moszbatimin e këtij plani veprimi për hapjen e qendrave rinore në të gjitha prefekturat e vendit.

Programi “Edukimi përmes kulturës”²⁴ ka nisur të formësohet në vitin 2014, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, vit kur edhe janë iniciuar projektet e para educative, në bashkëpunim me institucionet kulturore të varësisë, kryesisht në Tiranë. Kjo formë e qasjes ndaj ngritjes së njohurive dhe vetëdijes së brezave për rëndësinë dhe përfitimin nga arti, kultura dhe trashëgimia kulturore, ka hasur në interesim të madh të pjesëmarrësve të grupmoshave të ndryshme²⁵. Ndikimi pozitiv i zbatimit të këtij programi dëshmohet nga rritja prej 55%, e numrit të vizitorëve në institucionet kulturore, përmes pjesëmarrjes në aktivitete kulturore dhe edukuese në këto institucione, tendencë e cila shihet me prioritet për zhvillim më të gjerë.

Strategjia Kombëtare e Kulturës, 2019-2020 parashikon një objektiv specifik, atë të edukimit përmes kulturës. Programi “Edukimi përmes

²² Miratuar me vendimin nr.383, datë 6.5.2015, të Këshillit të Ministrave

²³ Në mbështetje të vendimit nr.505, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, MASR është institucioni përgjegjës për zhvillimin dhe koordinimin e politikave rinore.

²⁴ Strategjia Kombëtare për Kulturën, 2019-2020

²⁵ Përmes këtij programi është synuar njohja e brezave të rinj me artin dhe trashëgiminë kulturore në Shqipëri dhe nxitja e dëshirës për të krijuar dhe çmuar pasuritë kulturore. Gjatë vitit 2018, programi ka arritur përfshirjen e numrit rekord prej 55.000 nxënësish të moshave të ndryshme nga rreth 500 shkolla në gjithë vendin, me pjesëmarrje në rreth 700 aktivitete të organizuara nga institucionet kulturore të varësisë. Përmes programit Edukimi Përmes Kulturës është punuar edhe në identifikimin e talenteve të reja, si dhe është krijuar baza e qëndrueshme për publikun e së ardhmes

kulturës”, i zbatuar nga institucionet kulturore të varësisë, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet arsimore, ka rezultuar të jetë mjaft i suksesshëm në nxitjen e nxënësve të sistemit parauniversitar për përfshirje në aktivitete edukuese në institucione kulturore dhe jashtë tyre²⁶. Problematika e identifikuar gjatë zbatimit disavjeçar të programit, është përqendrimi i aktiviteteve kryesisht në zonat urbane të vendit, e veçanërisht në qytetin e Tiranës, ku gjenden numri më i madh i institucioneve kulturore të varësisë.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat Fëmijëve dhe plani i veprimit, 2017-2020²⁷ përfaqëson një dokument strategjik, i cili shpreh prioritetet e institucioneve shtetërore në fushën e të drejtave të fëmijëve, si dhe njëkohësisht, një kuadër të unifikuar për monitorimin e progresit të qeverisë shqiptare drejt realizimit të të drejtave të fëmijëve, në të gjithë sektorët relevantë. Në këtë kontekst, dokumenti është bazuar në rishikimin e dokumentave strategjike të mëposhtëm:

- Dokumentat Strategjike Sektoriale të Rishikuar dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;
- Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, 2014 – 2020;
- Strategjia e Mbrojtjes Sociale, 2015 – 2020;
- Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale, 2016 – 2020;
- Plani i Veprimit për Fëmijët në Situatë Ruge, 2015 – 2017;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë, 2015 – 2020;
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, 2014 – 2020;

²⁶ Programi synon, që institucionet arsimore dhe kulturore të ndihmojnë brezin e ri që të zhvillojë vetëbesimin, si individë dhe anëtarë të grupeve të ndryshme brenda shoqërisë; t’i inkurajojë ata për të zhvilluar një gamë të gjerë të aftësive dhe interesave të tyre; të identifikojë dhe nxisë potencialin e tyre, si dhe të zhvillojë kreativitetin e tyre. Ai gjithashtu, synon njohjen e vlerave të trashëgimisë materiale dhe jomateriale të vendit, nëpërmjet projekteve të ndryshme brenda programit. Përmes këtij objektiivi synohet shtrirja e programit të edukimit në tërë vendin, duke filluar nga projektet e ekzistuese të suksesshme, të cilat në bashkëpunim me nivelin vendor dhe institucionet e tyre të varësisë mund të realizohen në qytetet e tjera, por gjithashtu theksi do të vihet në hartimin e projekteve të reja sipas specifikave të identifikuara. Programi i edukimit do të zgjerohet edhe te operatorët e pavarur, përmes projekteve me thirrje, me qëllim pjesëmarrjen e gjerë të të rinjve në vendet, ku institucionet kulturore vendore dhe qendrore e kanë të vështirë të shtrijnë veprimtarinë e tyre. Integrimi i personave me aftësi të kufizuar dhe pakicave kombëtare, përmes programit “Edukimi përmes kulturës” është një nga masat e ndërmarra, që do të zbatohet jo vetëm përmes projekteve ekzistuese, por edhe nëpërmjet projekteve të hartuara enkas për qasjen sipas nevojave të komuniteteve.

²⁷ Vendimi nr.372, datë 26.4.2017, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020”. Agjenda synon të arrijë mbrojtjen dhe promovimin efektiv të të drejtave të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar standartet ndërkombëtare dhe kombëtare në këtë fushë dhe duke nxitur një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse për të drejtat e fëmijëve. AKDF paraqet një kuadër shumëdisiplinor dhe sistematik, i cili duhet të integrohet në të gjitha dokumentet, planet dhe veprimtaritë e tjera kombëtare dhe lokale të lidhura me fëmijët, në frymën e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve.

- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016-2020
- Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues, 2017 - 2021 ;
- Strategjia e Luftës Kundër Trafikimit të Personave dhe Plani i Veprimit, 2014 -2017;
- Strategjia Ndërsektoriale, Axhenda Dixhitale e Shqipërisë, 2015 – 2020;
- Strategjia e Strehimit Social, 2016 – 2025.

Agjenda përmban tri shtylla strategjike:

- **Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.** Në këtë drejtim, Agjenda synon përforcimin e kuadrit rregullator dhe institucional, duke përfshirë mekanizmat e pavarur monitorues, përmirësimin e monitorimit të situatës së të drejtave të fëmijëve në mënyrë që të gjenerohen të dhëna, që ushqejnë politika efektive, si dhe ngritjen e mekanizmave pjesëmarrës të fëmijëve në vendimmarrje.
- **Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve.** Agjenda synon ngritjen e një sistemi të integruar dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve, nëpërmjet një kuadri ligjor dhe institucional, të përmirësuar ndjeshëm.
- **Sisteme dhe shërbime miqësore ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve: zhvillimi, arsimimi, drejtësia, shëndeti, ushqyerja dhe mbrojtja sociale.** Në këtë aspekt, është synuar më së shumti, evidentimi i masave kryesore të strategjive sektoriale, për të arritur vlerësimin e progresit të të drejtave të fëmijëve në këto fusha.

E drejta e fëmijës për pushim dhe argëtime kulturore e sportive

E drejta e fëmijës për t'u argëtuar konsiston në praktikimin e veprimtarive çlodhëse dhe lojrave të ndryshme, të përshtatura me moshën e fëmijës, si dhe nxitjen e fëmijës për të qenë pjesëmarrës në jetën kulturore dhe artisitike, në mjedise të përshtashme për ta. Në këtë kuptim, loja është aktivitet shoqëror, që eliminon prirjen drejt lakmisë dhe arrogancës dhe zhvillon kujdesin mbi ndjenjat dhe mirëqenien e të tjerëve. Mbi të gjitha, loja është shprehje e lirisë.

Psikologjia e zhvillimit të fëmijëve e konsideron lojën si një mjet të rëndësishëm për kapërcimin e prirjes së lindur të fëmijës, të agresionit dhe dominimit.

Ashtu sikurse e theksuam më lart, loja tek fëmijët eliminon prirjen drejt lakmisë dhe arrogancës dhe zhvillon kujdesin mbi ndjenjat dhe mirëqenien e të tjerëve. Një shoqëri, e cila harron se si zhvillohen lojërat, është një shoqëri që rrit individë të izoluar (vetjakë). Mbi të gjitha, loja është shprehje e lirisë. Ajo është çdo gjë, vetëm jo obligim, fëmijët pranojnë që t'u binden rregullave të caktuara, të cilat vendosen me marrëveshje ndërmjet tyre. Prandaj, loja është një ndër aktivitetet më demokratike. Fëmijët nuk mund t'i mësojnë vlerat demokratike nëpërmjet aktiviteteve, të cilat i bëjnë të rriturit, por në mënyrë të dedikuar, vetëm nëse i shijojnë vetë, nëpërmjet formave të bashkëveprimit me fëmijët e tjerë, e kryesisht, nëpërmjet lojës. Kjo është situata, në të cilën të gjithë fëmijët janë të barabartë, vendosin bashkërisht, por, ajo që është më e rëndësishme, patjetër duhet të respektojnë të drejtat e të tjerëve, po qe se dëshirojnë që edhe vetë të marrin pjesë.

Sikundër, duhet të dallojmë lojën e organizuar dhe zhvilluar nga vetë fëmijët (si psh video-lojërat, të parit e TV-së), të cilat në teroinë e psikologjisë së zhvillimit të fëmijës, nuk konsiderohen lojëra. Kjo, për faktin, se nuk ka bashkëveprim dhe komunikim me fëmijë të tjerë.

Një element të rëndësishëm që loja zhvillon tek fëmijët, është bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe jo garë (p.sh fëmijët, të cilët luajnë së bashku me njëri-tjetrin në një park, me topa djeks, me kartat UNO, etj), pasi, në këtë marrëdhënie ndërveprimi, ata nuk i kushtojnë rëndësi "fitores", se sa i kushtojnë rëndësi bashkëpunimit dhe nxisin respektin reciprok.

Prania e të rriturve e çon lojën e fëmijëve në gara dhe, atëherë ajo i humbet elementët e lojës. Shkathtësia e fëmijës gjatë lojës me fëmijët e tjerë, është e rëndësishme në zhvillimin social, pasi përcjell kënaqësi tek të gjithë fëmijët në lojë dhe njëkohësisht, plotëson dëshirat dhe nevojat vetjake. Kjo është pikërisht ajo, që loja i mëson fëmijëve – të jenë në harmoni me fëmijët e tjerë, të bashkëveprojnë e bien dakord ndërmjet tyre, të marrin në konsideratë nevojat e të tjerëve. Për t'i joshur fëmijët e tjerë që të luajnë, fëmijët me patjetër duhet të mësojnë që të vënë veten në pozitën e të tjerëve (procesi i empatisë). Sjelljet që fitojnë fëmijët gjatë tërheqjes apo shtytjes për të luajtur (procesi i atashimit), e cila ndodh te fëmijët, nuk është nevojë e thjeshtë për argëtim. Ajo është pikërisht shtytje për mbijetesë, për t'u atashuar, për të plotësuar nevojat, për të qenë në grup, pra loja është një mënyrë thelbësore, një ndër format kryesore, që nxit tek fëmijët arritjen e shkathtësisë, vlerave dhe njohurive, të cilat janë të domosdoshme që të mësojnë kufijtë e lirisë në një shoqëri. Loja për fëmijët është element i domosdoshëm, që ndikon pozitivisht në zhvillimin fizik, emocional dhe intelektual (konjuktiv), njohës në zhvillimin dhe mirërritjen e fëmijës.

Loja është mjedis i sigurt për fëmijët dhe rrit besimin tek ta. Nëpërmjet lojës, fëmijët zhvillojnë imagjintatën, duke e transformuar realitetin në një mjedis të sigurt për ta. Në këtë mënyrë, ata mësojnë që të ballafaqohen me sfidat reale. Për ta, loja është edhe përvojë, edhe trajnim. Prandaj, edhe mënyra se si luajnë fëmijët, shpreh veçoritë e shoqërisë në të cilën ata jetojnë. Në lojërat e tyre fëmijët praktikojnë situata, që lidhen me jetën reale²⁸, duke i mbujtur ata me cilësi dhe shkathtësi, që do t'u nevojiten në shoqërinë e tyre.

Po kështu, në shoqëritë moderne, ku zhvillimi i teknologjisë është në nivele të larta, fëmijët janë dhe bëhen ekspertë në përdorimin e mjeteve të teknologjisë e komunikimit, si psh: kompjuterave, programeve të reja të komunikimit, etj, më shpejt se sa prindërit e tyre.

Përfshirja e të rriturve në lojrat e fëmijëve ndikon negativisht dhe loja shndërrohet në ankesa, fëmijët sillen me më pak përgjegjësi dhe pjekuri, sesa kur luajnë me bashkëmoshatarët e tyre. Në këtë mënyrë, humbet fryma e vërtetë e lojës. Loja i mëson fëmijët me shkathtësinë e negociatave, zgjidhjen e problemeve dhe me mbështetjen në vetvete. Loja, e cila nuk mbikëqyret, është me rëndësi kryesore për zhvillimin emocional dhe social të fëmijëve. Ajo ndihmon që fëmija të mësojë rregullat shoqërore, si edhe të mësojë t'i krijojë vetë rregullat e veta. Zvogëlimi i pjesëmarrjes në lojë në fëmijëri shprehet në aftësinë e tyre, në ndërtimin e marrëdhënieve me njerëzit kur të rriten. Nëpërmjet lojës, fëmija mëson të japë dhe marrë, kupton dhe dallon ndjenjat e të tjerëve, mëson të zgjidhë konfliktet, element i rëndësishëm në ndërtimin e marrëdhënieve me të tjerët.

Ndaj, është e nevojshme për të marrë të gjitha masat, për krijimin e mundësive të përshtatshme, për të nxitur fëmijët drejt argëtimit, edhe nëpërmjet lojës si një prej formave të tij, gjatë kohës së lirë.

Në të gjithë këtë analizë, qëllimi ynë është, jo vetëm apeli ndaj vetes dhe aktorëve kyç, pjesë e sistemit të integruar të mbrotjes së fëmijës, por edhe për të kuptuar, sesa pak kemi bërë, që fëmijët e sotëm të luajnë vërtet, pa mbikëqyrjen e të rriturve, ashtu siç kemi luajtur edhe ne dikur, në fëmijërinë tonë.

Kjo mungesë vëmendjeje dhe veprimi konkret, është shkaku kryesor i problemeve serioze që shfaqen sot tek fëmijët në shoqërinë në të cilën jetojmë, probleme si obeziteti, depresioni, humbja e aftësive për t'u

²⁸ Sjellim në vëmendje, se raca njerëzore nuk dallon nga ajo e kafshëve p.sh të vegjlit e luanëve apo kafshëve të tjera grabitqarë luajnë lojën e vështimit dhe të ndjekjes, barngrënësit (siç janë zebrat dhe antilopat), luajnë lojën e ikjes dhe shmangies, majmunët lojën e kërcimit dhe të ngjitjes në drunj.

përshtatur me mjedisin, etj. Fëmijët e sotëm janë gjenerata e re, e cila po rritet pa mundësinë për t'i mësuar vlerat e vërteta shoqërore nëpërmjet lojës.

Gjetjet dhe përfundimet

Në vlerësim të analizës krahasuese, pasojës së rëndë (humbja e jetëve të dy fëmijëve), në ngjarjet e ndodhura në të dy qytetet e vendit dhe, parashikimeve ligjore, që garantojnë të drejtën e fëmijës për t'u argëtuar, institucioni i Avokatit të Popullit konstaton, se neni 19, i ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” ka më shumë karakter deklarativ, sesa garantues, lidhur me këtë të drejtë (pavarësisht formës dhe përmbajtjes së kësaj dispozite). Thënë kjo, jo vetëm që e drejta për t'u argëtuar e fëmijës nuk gjen zbatim korrekt në praktikë, por edhe veprimtaria e autoriteteve shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, nuk është aspak e harmonizuar me kuadrin ligjor në fuqi, i cili drejtëpërdrejt ose jo, afekton ushtrimin e të drejtës së fëmijës për t'u argëtuar, e shtjelluar pikërisht në dritën e këtij legjislacioni, në këtë raport sintezë.

Ligji nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” është gjithëpërfirës dhe, përcakton të drejtat, aksesin në të drejta, mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës që garantojnë realizimin me efektivitet të mbikëqyrjes, promovimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave, si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijët. Gjithashtu, ai përcakton mekanizmat efikasë dhe parimet për organizimin e funksionimin e institucioneve përgjegjëse, të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Por, ajo që vërehet, është se parashikimet²⁹ e këtij ligji, nuk janë të integruara në ligjet specifike³⁰, për vendosjen e standardeve të sigurisë dhe aksesimit për të gjitha mjediset çlodhëse dhe këndet e lojërave, me qëllim mbrojtjen e fëmijës nga dëmtimet e mundshme të shëndetit. Po kështu, mangësi të dukshme shfaqen në drejtim të vendosjes së standardit për numër fëmijësh, për miratimin e kuadrit rregullues urbanistik, për të garantuar hapësira urbane të përshtatshme dhe aksesin e sigurt në mjedise sportive, kënde lojërash ose mjedise të tjera çlodhëse për të gjithë fëmijët, pavarësisht moshës, gjinisë, racës, etnisë, aftësisë ose kushteve sociale ekonomike.

Ndërkohë, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, si institucioni që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, planifikon, ekzekuton, mbështet dhe mbikëqyr të gjitha ndërhyrjet

²⁹ Neni 19, i ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

³⁰ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

për mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu, ajo është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve, në zbatimin e politikave të mbrojtjes, përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave, për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna .

Në këtë kontekst, Agjencia monitoron dhe kontrollon zbatimin në praktikë të ligjit nr.18/2017 “Për drejtat dhe mbrojtjen e Fëmijës”, si dhe të Agjendës Kombëtare për të Drejtat Fëmijëve e planit të saj të veprimit.

Nga analizimi i këtij dokumenti (Agjendës Kombëtare për të Drejtat Fëmijëve 2017-2020) vërehet, se qasja që ky dokument i rëndësishëm politikash paraqet, konsiston në mbrojtjen e fëmijës, duke nxitur të gjitha strukturat, hallka të zinxhirit të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në nivel qendror dhe vendor, në integrimin e fëmijës në nevojë për mbrojtje, bazuar kjo gjetje edhe, në të gjitha dokumentet, planet dhe veprimtaritë e tjera kombëtare të sipërpërmendura, të cilat janë pjesë integrale e Agjendës Kombëtare për të Drejtat Fëmijëve.

Pra, Agjenda në vetvete është e fokusuar **vetëm në konceptin “mbrojtje”, duke spostuar kështu, procesin e garatimit të të drejtave të fëmijës në përgjithësi dhe, në rastin konkret të drejtën e fëmijës për t’u argëtuar.**

Vlerësimi i legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi, të analizuar në këtë raport tregojnë, se e drejta e fëmijës për t’u argëtuar është e përfshirë në mënyrë të fragmentizuar dhe, në më të shumtën e rasteve, kur flitet për të, dispozitat ligjore janë të karakterit deklarativ. Mungesa e harmonizimit të legjislacionit të brendshëm, për të drejtën e fëmijës për t’u argëtuar, ka krijuar boshllëqe në plotësimin e plotë të kuadrit të ri ligjor në këtë drejtim, por edhe ka passjellë vështirësi në zbatimin e tij konkretisht në praktikë.

Të gjitha të drejtat janë të barabarta, të pandara dhe të ndërvarura. Kjo, do të thotë, që asnjë e drejtë nuk është më e rëndësishme se tjetra, e për më tepër, të drejtat janë të lidhura ngushtë e të ndërvarura me njëra-tjetrën.

Në këtë kuptim, në funksion të zbatimit korrekt të kuadrit të ri ligjor për mbrojtjen e fëmijës dhe harmonizimit të tij me ligjet specifike, me qëllim përmirësimin e legjislacionit, për të forcuar zbatimin efikas të të drejtës së fëmijës për t’u argëtuar, institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të neneve 21 dhe 24, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

REKOMANDON:

- Marrjen e masave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për të harmonizuar nenin 19, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” me ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, për vendosjen e një standardi, që në raport me një numër të caktuar fëmijësh, të ndërtohet një numër i caktuar kënde lojrash ose mjedise të tjera çlodhëse, pavarësisht moshës, gjinisë, racës, etnisë, aftësisë ose kushteve social-ekonomike.
- Marrjen e masave nga Agjensia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, për të bërë të mundur vlerësimin e akteve ligjore³¹ në fuqi dhe dokumenteve politikë apo strategjikë³², të cilat drejtpërdrejt ose jo, lidhen me të drejtën e fëmijës për t’u argëtuar, për t’i bërë pjesë integrale të Dokumentit Politik Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve, pas vitit 2020.
- Marrjen e masave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të vlerësojnë dhe propozojnë ndryshime ligjore në ligjin nr.9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes”, të ndryshuar, me qëllim detajimin konkret të përgjegjësisë prindërore, lidhur me të drejtën e fëmijës për të luajtur, argëtuar e pushuar.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454, datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për miëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA

³¹ Ligjet nr.75/2019 “Për rininë” dhe nr.79/2017 “Për sportin”.

³² Strategjia Kombëtare për Kulturën, 2019-2025.

